



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## VENDIMET E BORDIT TË FBK-së TË DATËS 07.07.2020, PRISHTINË

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) më 07.07.2020 ka marrë këto vendime:

1. Paraqitja e klubeve për regjistrim për edicionin e ri të garave 2020-2021 të bëhet në datat prej **01.08.2020 deri më 20.08.2020**;
2. Afati kalimtar për basketbollistë/e: **10.08.2020 – 07.09.2020**;
3. Aprovimi i Propozicioneve të Garave për ligat seniore në të dyja konkurrencat: **28.08.2020**;
4. Aprovimi i Kalendarit të Garave për ligat seniore në të dyja konkurrencat: **28.08.2020**;
5. Zhvillimi i ndeshjeve të play-out-it (Superliga e Kosovës dhe Liga e Parë e Meshkujve): **02-05.09.2020**;  
***Theksim:** Ndeshjet e Play Out-it do të zhvillohen sipas Propozicioneve të Garave 2019-2020, sistemin e Garave 2019-2020 dhe për shkak të situatës së re të krijuar me shfaqjen e pandemisë COVID-19 me rosterin e lojtarëve nga edicioni i ri 2020-2021.*
6. Hudhja e shortit të të gjitha ligave seniore në të dyja konkurrencat: **06.09.2020**;
7. Organizimi i FIBA SCOD Klinika para-sezonale (testimet nga njohja e rregullave të basketbollit dhe FIBA Fitnes testi) më së largu më **30.08.2020** dhe ritestimi eventual më **06.09.2020**;
8. Aprovimi i listës së gjyqtarëve për edicionin e ri nga Bordi i FBK-së më **07.09.2020**;
9. Organizimi i Superkupës së Kosovës në të dyja konkurrencat në formë të turneut prej **16 deri më 20.09.2020**;
10. Fillimi i edicionit të ri (2020/21) në Superligën e Kosovës më **23/24.09.2020**;

Vendimet hyn në fuqi menjëherë.

Në emër të Bordit të FBK-së,  
Arben FETAHU  
Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)

